



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHPIMI I PUSEVE TË NAFTËS, GAZIT DHE UJIT”

X2-III-16

Niveli III KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

Tiranë, Tetor 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	X2-III-16
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK është të përgatisë punonjës të kualifikuar, për t’u punësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e shpimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit në shërbimet e ofruara nga këto fusha, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit”, të nivelit të tretë në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kanë mbaruar kualifikimin profesional, “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; • janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë dhe ai ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin teknik/menaxher. Me arsimim të mëtejshëm ai fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në sipërmarrje të ndryshme që kryejnë veprimtari në shpimin e puseve të naftës, të gazit dhe ujit dhe në kompani të ndryshme shërbimi në industrinë e naftës dhe në fushën e gjeologjisë inxhinierike.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka (në të kundërt shënohet titulli dhe kodi)			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Sfondi i përgjithshëm profesional

- Të shpjegojë dokumentacionin teknik të profesionit të rilevuesit, sondistit, përgjegjësit të kyçit, pontistit (punëtorit të manovrave) si dhe pompistit e operatorit të prodhimit;
- Të përshkruajë specifikat e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në industrinë e naftës (punimet e shpimit dhe të nxjerrjes);
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së shpuesit, kryesondatorit, sondistit, pompistit, pontistit, shllamistit dhe motoristit.
- Të përshkruajë karakteristikat e pajisjeve në shfrytëzimin e naftës dhe gazit si; pompat e thellësisë, purtekat, vulfet (lëkundësit), filtrat, pakerat etj.;
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së: kërkimit, shpimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit;
- Të përshkruajë veçoritë e rreziqeve gjatë punës në industrinë e naftës (punimet e shpimit dhe të shfrytëzimit);
- Të përshkruajë masat për parandalimin si dhe rehabilitimin e mjedisit në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
- Të dallojë mjetet e punës dhe pajisjet e nevojshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës;

SHPIMI I PUSEVE

Sondat e shpimit

- Të përshkruajë sondën e shpimit për shpimin e një pusi sipas një projekti të dhënë;
- Të përshkruajë përgatitjet për fillimin e shpimit të një pusi;
- Të përshkruajë veçoritë e sondave të shpimit sipas thellësisë së shpimit;
- Të tregojë pjesët përbërëse të një sonde shpimi;
- Të shpjegojë funksionet e elementëve të një sonde shpimi;
- Të shpjegojë funksionimin e pjesëve të një pompe shpimi;
- Të shpjegojë funksionimin e agregatëve të fuqisë të një sonde shpimi;
- Të shpjegojë funksionimin e drillometrit për dhënien e peshës mbi daltë dhe interpretimin e kartogramës së procesit të shpimit ;
- Të shpjegojë funksionimin e pajisjeve të sistemit të pastrimit të lëngut larës;
- Të shpjegojë funksionimin e preventorëve të fontanave dhe linjave anësore të tij;
- Të shpjegojë funksionimin e bllokut të makarave;

- Të shpjegojë funksionimin e topdriver-it;
- Të shpjegojë funksionimin e rotorit;
- Të shpjegojë funksionimin e kyçeve të mbërthimit të tubave, kunjave etj.

Instrumenti i shpimit

- Të shpjegojë funksionet dhe përbërjen e kolonës së shpimit;
- Të shpjegojë funksionet dhe karakteristikat e tubos drejtuese, tubave të shpimit dhe atyre rëndues;
- Të shpjegojë standardet e prodhimit të tubove të shpimit;
- Të shpjegojë funksionet dhe karakteristikat e tubave rëndues;
- Të shpjegojë dhënien peshës mbi daltë me mënyrën automatike apo manuale;
- Të shpjegojë vlerësimin e konsumimit të tubave të shpimit dhe tubove rëndues;
- Të përshkruajë masat përgatitore për ngritjen dhe uljen e instrumentit të shpimit;

Daltat e shpimit

- Të shpjegojë kriteret e zgjedhjes së daltave për shpimin e një formacioni të caktuar;
- Të shpjegojë veprimin hidromonitor të daltave të shpimit;
- Të shpjegojë funksionimin e daltave për marrjen e kampionit dhe të kampion marrësve;

Konstruksioni i pusit

- Të shpjegojë konstruksionin e një pusi;
- Të shpjegojë pjesët përbërëse të një konstruksion pusi;
- Të shpjegojë hapat për hartimin e konstruksionit të një pusi;
- Të shpjegojë mënyrat e mbërthimit dhe zberthimit të elementëve të kolonës së rrethimit .
- Të shpjegojë procedurat për uljen e një kolone rrethimi, radha e punës ;
- Të përshkruajë pajisjet e kolonave të rrethimit dhe funksionet e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e centrorëve dhe tipin e tyre;

Çimentimi i kolonave të rrethimit

- Të shpjegojë procesin e çimentimit të një kolone rrethimi;
- Të përshkruajë të gjithë etapat e procesit të çimentimit të një kolone rrethimi;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së suspensionit të çimentos;
- Të rendisë parametrat e suspensionit të çimentos;
- Të rendisë parametrat e gurit të çimentos;
- Të shpjegojë metodat e çimentimit të puseve për raste të ndryshme (raste tipike dhe raste speciale);
- Të listojë aparaturat vlerësimi e parametrave të suspesionit dhe gurit të çimentos.
- Të shpjegojë masat që merren pas përfundimit të procesit të çimentimit;

Larja e pusit dhe lëngu larës

- Të përshkruajë llojet e lëngjeve larës;
- Të shpjegojë aparaturat dhe metodikat e matjes së parametrave të lëngut larës;

- Të përshkruajë procesin e pastrimit të shllamit dhe degazifikimin e lëngut larës;
- Të përshkruajë përpunimin kimik të lëngjeve larës;
- Të listojë reagentët për përpunimin kimik të lëngjeve larës;

Ndërlikimet dhe avaritë

- Të shpjegojë shkaqet e ndërlikimeve gjatë shpimit të puseve;
- Të shpjegojë shkaqet e bllokimit të kolonës së shpimit;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së vendbllokimit të kolonës së shpimit;
- Të përshkruajë banjot me naftë, me acid, etj. për zhbllokimin e instrumentit të bllokuar;
- Të shpjegojë mënyrat për zhbllokimin e instrumentit të shpimit;
- Të shpjegojë ardhjen e fluideve nga shtresa (manifestimet) dhe ardhjen e pakontrolluar (fontanat);
- Të shpjegojë masat për nënshtrimin e ardhjeve të pakontrolluara të fluideve (fontanave);

NXJERRJA E NAFTES DHE GAZIT

Metodat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës dhe klasifikimi i tyre

- Të shpjegojë klasifikimin e metodave të shfrytëzimit parësor të vendburimeve të naftës;
- Të shpjegojë metodën e shfrytëzimit me errupsin natyror;
- Të argumentojë kalimin në metodën e shfrytëzimit me erupcion artificial;
- Të shpjegojë metodën e shfrytëzimit të puseve të naftës me pompa thellësie,
- Të argumentojë kur përdoren pompat elektrocentrifugale zhytëse dhe pompat me burme;

Vënia në punë e pusit

- Të listojë faktorët teknologjike që ndikojnë në ndotjen e shtresës prodhimtare,
- Të shpjegojë mënyrat e uljes së depresionit në fund të tij;
- Të shpjegojë përvetësimin e pusit dhe qëllimin e kryerjes;
- Të shpjegojë mënyrat e ndryshme të përvetësimit të pusit;
- Të përmbledhë në skema teknologjike mënyrat e kryerjes së përvetësimit të pusit;

Kompletimi i puseve të shfrytëzimit

- Të listojë pajisjet mbi dhe nëntokësore të puseve që shfrytëzohen me errupsion natyror;
- Të shpjegojë arsyet e studimit të puseve me fontanim natyror;
- Të vizatojë skemën e përgatitjes së pusit, me pajisjet që nevojiten për studim.
- Të interpretojë vizatimet e pajisjeve në thellësi të një pusi që shfrytëzon naftën dhe gazin;
- Të shpjegojë pajisjet e kokës së kolonës dhe atë të grykës së pusit në rastet kur shfrytëzimi bëhet me errupsion natyror (fontanë), me kompresor dhe me pompë të thellësisë;

- Të dallojë pajisjet e grykës së pusit dhe të thellësisë që përdoren për metoda të tjera të shfrytëzimit si me pompat elektrocentrifugale zhytëse, pompave me burmë, pompave me ezhektor;
- Të shpjegojë mënyrat dhe radhën e veprimeve për vënien e një pusi nafte në shfrytëzim për çdo metode shfrytëzimi;

Metodat dhe pajisjet e shfrytëzimit të puseve të naftës me pompa thellësie

- Të shpjegojë mënyrat dhe radhën e veprimeve për vënien e një pusi nafte në shfrytëzim;
- Të rendisë pjesët kryesore të impiantit sipërfaqësor të nxjerrjes së naftës (lëkundësit);
- Të dallojë pjesët e ndryshme të lëkundësit dhe të diferencojë pjesët mekanike nga ato elektrike;
- Të shpjegojë mënyrën e shfrytëzimit të puseve të naftës me pompa thellësie;
- Të listojë pompat e thellësisë dhe pjesët kryesore të saj;
- Të llogarisë debitin e pompës dhe të qartësojë koeficientin e mbushjes së pompës;
- Të shpjegojë kalimin në shfrytëzimin e puseve me pompa thellësie pa purteka;

Grumbullimi dhe transporti i naftës e gazit.

- Të shpjegojë sistemet e tubacioneve dhe rezervuarët e grumbullimit të naftës;
- Të shpjegojë mënyrat e trajtimit dhe ndarjes (seperimit) të gazit;
- Të shpjegojë pompat e naftës dhe pompat (kompresorët) e gazit dhe qëllimin e përdorimit;
- Të shpjegojë sektorët e grumbullimit dhe transportit të naftës;
- Të rendisë veprimet gjatë operacioneve të nxjerrjes së naftës nga pusi në kolektor, në rezervuarët e naftës deri në stacionin e grumbullimit të vendburimit.

Remonti nëntokësor.

- Të shpjegojë shkaqet e remontit nëntokësor të një pusi nafte dhe një pusi gazi;
- Të gjykojë për mundësinë e riparimit nëntokësor dhe llojin e punimeve që do kryhen;
- Të dallojë riparimi i zakonshëm nëntokësor me riparimet kapitale të pusit;
- Të shpjegojë përbërjen e kompletimit të një pusi që nga kolona e shfrytëzimit të një pusi nafte apo gazi dhe në kompletime të tjera, në vartësi të punimeve që do të kryhen në të;
- Të shpjegojë veçoritë e shfrytëzimit dhe të riparimit nëntokësor të puseve në det.

Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të analizojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në punimet e kërkimit, shpimit dhe ato të nxjerrjes së naftës, gazit e ujit;
- Të analizojë kushtet e punës në punimet e kërkimit, shpimit të puseve dhe të nxjerrjes së naftës dhe të gazit;
- Të shpjegojë aksidentet që ndodhin gjatë shpimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit;
- Të shpjegojë rreziqet që vijnë nga prania e gazeve helmuese në kantieret e shpimit dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit, në raste të manifestimeve apo edhe në rastet e fontanave të hapura;

- Të shpjegojë aksidentet që mund të ndodhin gjatë kryerjes së proceseve të manovrave në shpimin e puseve dhe në remontin e puseve të naftës dhe gazit;
- Të shpjegojë rreziqet nga pajisjet elektrike në kushte pune normale dhe në ditë me shira dhe lagështi;
- Të shpjegojë dëmtimet e shëndetit nga zhurmat e që krijohen gjatë punës së sondave, traktorëve, vinçave etj, masat mbrojtëse dhe pajisjet e nevojshme personale;
- Të shpjegojë dëmtimet e shëndetit nga kushtet e vështira atmosferike në periudhat e ftohta dhe me reshje dëbore;
- Të shpjegojë burimet e aksidenteve nga makineritë e ndryshme që funksionojnë në sondën e shpimit, në traktorët dhe sondat e remontit nëntokësor të puseve të nxjerrjes së naftës, gazit, etj.;
- Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, si dhe rolin e ndriçimit dhe krijimin e kushteve të sigurta në punë;
- Të analizojë përdorimet e mjeteve të mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, nxjerrjes së naftës dhe përdorimit të metodave të dyta etj.;

SHPREHIPROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sfondi i përgjithshëm profesional

- Të kryejë kontroll të vazhdueshëm të veglave që përdor;
- Të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e punës sipas operacioneve përkatëse në kantier;
- Të përdorë pajisjet dhe mjetet e ndryshme në fronte të ndryshme të punës si ato të kryesondistit, të punëtorit të kyçit, të pompistit, të pontistit, të mbikëqyrësit të lëngut larës, të motoristit, të mirëmbajtësit, të punëtorit të pastrimit, etj.;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;

SHPIMI I PUSEVE

Sondat e shpimit

- Të vë në punë elementët e një sonde shpimi;
- Të demonstrojë vënien në punë të pompave të lëngut larës;
- Të provojë funksionimin e agregatëve të fuqisë të një sonde shpimi;
- Të realizojë dhënien e peshës mbi daltë në përputhje me parametrat e regjimit të shpimit;
- Të vë në punë pajisjet e sistemit të pastrimit të lëngut larës;
- Të provojë përdorimin e preventorëve të fontanave;
- Të demonstrojë vënien në punë të motorit ajror (topdriver);
- Të provojë funksionimin e rotorit;
- Të montojë pjesët përbërëse të sondës së shpimit;

- Të montojë pompat e lëngut larës;
- Të montojë pajisjet e sistemit të pastrimit të lëngut larës;
- Të montojë motorët dhe arganellon e sondës;
- Të demonstrojë tarimin, centrimin dhe vënien në punë të gjithë pajisjeve të shpimit të pusit;
- Të demonstrojë përdorimin praktik të të gjithë agregatëve kryesore të sondës së shpimit;
- Të përdorë pajisjet hermetizuese të grykës së pusit;
- Të kryejë mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve të sondës;

Instrumenti i shpimit

- Të kontrollojë instrumentin e shpimit, (tubat e shpimit, tubat rëndues, manikotat, reducionet, astakuadratën, centratorët, etj.);
- Të provojë dhënien e peshës mbi daltë;
- Të marrë masat para dhe pas manovrave për ngritjen dhe uljen e instrumentit të shpimit;
- Të kryejë operacionet e ulje-ngritjes së instrumentit të shpimit;
- Të përdorë kyçet dhe pajisjet për zbërthimin, mbërthimin dhe shtrëngimin e tubave të shpimit;
- Të përdorë ganxhat dhe pajisjet në urën (pontin) e manovrës për mbështetjen e tubave të shpimit gjatë manovrave të ulje-ngritjes së instrumentit të shpimit;

Daltat e shpimit

- Të provojë funksionimin e daltave për marrjen e kampionit dhe të kampion marrësve;
- Të demonstrojë mbërthimin dhe zbërthimin e kompletit karotier;
- Të vlerësojë shkallën e konsumimit të daltave te dala nga pusi.

Konstruksioni i pusit

- Të vizatojë konstruksionet e ndryshme te puseve;
- Të provojë procedurat për uljen e një kolone rrethimi;
- Të rendisë në urën e sondës, tubat e kolonës së rrethimit sipas radhës së uljes së tyre në pus;
- Të realizojë procedurën e shabllonimit tubove të kolonës së rrethimit para uljes;
- Të kryejë mbërthimin e tubave të kolonës së rrethimit;

Çimentimi i kolonave të rrethimit

- Të përgatisë suspensionin e çimentos, sipas programit të çimentimit;
- Të kryejë matjet e parametrave të suspensionin të çimentos dhe t'i dokumentoja ato gjatë procesit të çimentimit;

Larja e pusit dhe lëngu larës

- Të përgatisë lëngun larës sipas projektit të shpimit të pusit;
- Të kryejë matjet e gjithë parametrave të lëngut larës për shpimin e një pusi;
- Të kryejë përpunimin kimik të lëngut larës;

- Të përdorë pajisjet e përpunimit kimik të lëngut larës;

Ndërlikimet dhe avaritë

- Të kryejë banjot me naftë për zhbllokimin e instrumentit të bllokuar;
- Të zbatojë procedurat për zhbllokimin e instrumentit të shpimit;
- Të vlerësojë humbjet e lëngut larës në shtresë;
- Të vlerësojë ardhjet e fluideve nga shtresa;
- Të realizojë nënshtrimin e ardhjeve të fluideve nga shtresa;

NXJERRJA E NAFTES DHE GAZIT.

Metodat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës dhe klasifikimi i tyre

- Të grupojë metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës;
- Të skicojë klasifikimin e metodave të shfrytëzimit parësor të vendburimeve të naftës;
- Të dallojë kur përdoren pompat elektrocentrifugale zhytëse dhe pompat me burmë.

Vënia e pusit në punë

- Të grupojë faktorët teknologjike që ndikojnë në ndotjen e shtresës prodhimtare,
- Të përgatisë dhe të demonstrojë punimet për përvetësimin e pusit, qëllimin dhe mënyrat e realizimit të tij;
- Të vizatojë një skemë teknologjike mbi mënyrat e kryerjes së përvetësimit të pusit dhe monitorimin e tij;

Kompletimi i puseve të nxjerrjes së naftës

- Të montojë pajisjet në shfrytëzimin me fontanë dhe të organizojë si bëhet studimi i puseve me fontanim natyror;
- Të skicojë dhe të vizatojë konstruksionin e një pusi dhe pajisjet sipërfaqësore të një pusi që shfrytëzon naftën dhe gazin;
- Të mirëmbajë pajisjet e kokës së kolonës dhe atë të grykës së pusit në rastet kur shfrytëzimi bëhet me errupsion natyror (fontanë), me kompresor dhe me pompe thellësisë.
- Të montojë pajisjet e grykës së pusit dhe të thellësisë
- Të përcaktojë mënyrat dhe radhën e veprimeve për vënien e një pusi naftë në shfrytëzim.

Metodat dhe pajisjet e shfrytëzimit të puseve të naftës me pompa thellësie

- Të përcaktojë mënyrat dhe radhën e veprimeve për vënien e një pusi naftë në shfrytëzim;
- Të skicojë pjesët kryesore të impiantit sipërfaqësor të nxjerrjes së naftës (Lëkundësit);
- Të montojë dhe të mirëmbajë pompat e thellësisë dhe pjesët kryesore të saj;
- Të montojë kolonën e purtekave;
- Të përcaktojë kalimin në shfrytëzimin e puseve me pompa thellësie pa purteka;

Grumbullimi dhe transporti i naftës e gazit.

- Të përdorë sistemet e tubacioneve dhe rezervuarët e grumbullimit të naftës;
- Të mirëmbajë separatorët dhe depot e grumbullimit;
- Të mënjanojë rrjedhjet nga pompat e naftës dhe pompat (kompresorët) e gazit;
- Të parashikojë radhën e riparimit të zakonshëm të pompave të naftës dhe të kompresorëve;
- Të skicojë sektorët e grumbullimit dhe transportit të naftës, dhe ti grupojë sipas kapacitetit të tyre;
- Të zbatojë të gjitha manovrat (operacionet) që kryhen gjatë fazave të nxjerrjes së naftës nga pusi në kolektor, në rezervuarët e naftës deri në stacionin e grumbullimit të vendburimit;

Remonti nëntokësor

- Të kryejë operacionet e riparimit nëntokësor dhe llojin e punimeve që do kryhen;
- Të kryejë riparimet e zakonshëm nëntokësor
- Të skicojë dhe vizatojë elementet e kompletimit të një pusi që nga kolona e shfrytëzimit të një pusi naftë apo gazi.
- Të përdorë të dhënat e regjimit të shfrytëzimit të një pusi naftë dhe/ose gazi duke përfshirë riparimin nëntokësor dhe çdo punim tjetër të kryer për rritjen e naftënxjerrjes në hartimin dhe planifikimin e planeve të punimeve në puse;
- Të specifikojë veçoritë e shfrytëzimit dhe të riparimit nëntokësor të puseve në det.

SHËNDETI, SIGURIA NË PUNË DHE MBROJTJA E MJEDISIT:

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të punës në vendburimet e naftës e gazit;
- Të përdorë mjetet e shuarjes së zjarrit në kantier;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti në kantier, posaçërisht nga asfiksia nga gazi sulfidik;
- Të kryejë veprime praktike për rrethimin e zonave të rrezikshme në vendburim dhe të zonave përkohësisht të përdorura për operacione kantierale;
- Të kryejë punime rehabilituese në vendburimet e naftës dhe gazit;
- Të kryejë pastrimin e zonave të ndotura për arsye të ndotjes nga operacionet teknologjike;
- Të realizojë kushtet e punës në punimet e kërkimit, shpimit të puseve dhe të shfrytëzimit të naftës dhe të gazit në përputhje me standardet, kriteret dhe kushtet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të vlerësojë rrezikun që sjellin punimet nën presion dhe të marrë masat për respektimin e standardeve të punës në tubacione, rezervuare të naftës dhe separatorët e gazit;
- Të mirëmbajë hidrantët e stacioneve të grumbullimit të naftës dhe të demonstrojë që i përdor ato me efektivitetin e duhur.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme të fushës së nxjerrjes së naftës;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme në këtë fushë për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente për rritjen e naftënxjerrjes;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të shpjegojë vetëkontroll dhe siguri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë arritjet e tij/saj, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.